# Kasëm Berberi

PROKUROR NË PROKURORINË E RRETHIT TIRANË

**Deklaratat e analizuara:**

**16 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




Pasuria bruto nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2018 është rritur 1.5 herë

+ 901,116 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë
















## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2018 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Paga nga funksioni | 25,898,118 | 49.2% |
| Paga e familjarëve | 17,494,369 | 33.2% |
| Të ardhura nga biznesi | 5,208,659 | 9.9% |
| Të ardhura nga Qira | 502,500 | 1.0% |
| Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme | 2,800,000 | 5.3% |
| Te ardhura te tjera | 720,000 | 1.4% |
| **Total** | **52,623,646** | **100%** |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Subjekti Kasem Berberi në deklarimin e pasurisë për herë të parë, ndër të tjera deklaron gjendje cash 2,500,000 lekë nga të ardhurat nga avokatia e viteve 1992-1999 dhe kursimet nga paga. Në vitet në vijim, subjekti nuk deklaron në mënyrë specifike pakësimin e kësaj shume dhe nuk është e qartë nëse është përdorur apo vazhdon të mbetet gjendje deri në vitin 2018.

Në vitin 2010 deklarohet shtesë anësore pa leje në lokalin në pronësi në Gjirokastër me sipërfaqe 37 m2, në proces legalizimi.

Në vitin 2013, nëpërmjet transfertës bankare subjekti i kalon nipit një shumë prej 2,500,000 lekësh. Një vit më vonë, nipi i transferon në bankë 4,000,000 lekë, nga të cilat 2,500,000 lekë i përket shumës së marrë në vitin 2013 dhe 1,500,000 lekë buron nga të ardhurat e shoqërisë DA-AR shpk, ku djali i subjektit është ortak. Nuk është e qartë se çfarë përfaqëson shuma 1,500,000 lekë.

Në vitin 2015, djali i subjektit ka blerë një apartament me sip. 57 m2 kundrejt vlerës 40,000 euro, nga të cilat 2,000,000 lekë janë hua nga kunata. Lidhur me huanë nuk ka të dhëna mbi kushtet e huadhënies dhe deri me datë 31.12.2018, nuk është realizuar asnjë shlyerje.